




REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT	
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	Nr. Prot.
Dep.	Br. Prot.
Dep.	Prot No.
Nr. I faq.	01-177/14
Broj stranica	
Nr. pages	
PRISHTINE	
21.01.2014	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI – CORRUPTION AGENCY**

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit si dhe nenin 24 paragrafi 11 dhe 12 të Rregullorës së Punës të Agjencisë kundër Korruptionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korruptionit me datë 16.01.2014, nxjerr këtë:

V E N D I M

I, Mbylltet rasti me Nr. AKK-03-3562/13 për ztr. *Agron Kryeziu – Ish Drejtor i Inspektoriatit në Komunën e Gjakovës, për shkak se ai tashmë nuk e ushtron këtë funksion dhe rrjedhimisht nuk ka situatë të konfliktit të interesit.*

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK-03-3562-13, për Zyrtarin e lartë, z. Agron Kryeziu–Drejtor i Inspektoriatit në Komunën e Gjakovës, dhe njëkohësisht person i autorizuar në një biznes privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligi Nr. 04/L-051).

Në rastin me numër protokoli AKK-03-3562/13, të hetuar për ekzistimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, zyrtari i lartë, z. Kryeziu së pari është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korruptionit (Z.D.DPK-01-3947-13), pas të cilës zyrtari është kontaktuar nga zyrtarët e Agjencisë, me ç'rast është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet si dhe me ndryshimet që duhet të bëjë për të parandaluar situatën e mundshme të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Zyrtari i lartë, z. Kastrati është deklaruar se do të filloj procedurën për shhangjen e kësaj situatë të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, edhe pse ai me funksioni i tij si Drejtor i inspektoriatit konsideronte se është “në ikje” për shkak të ndrrimit të pushtetit komunal pas zgjedhjeve lokale.

Meqense kishte kaluar kohë, jashtë afateve të dhëna ligjore, dhe zyrtari i lartë nuk i ka bërë veprimet e duhura për të shhangur këtë situatë, Agjencia kundër Korruptionit, konform nenit 18

paragafi 5 i Ligjit Nr.04/L-051 për parandalimin e konflikti të interesit në ushtrimin e funksionit publik i ka bërë edhe shkresën e dytë – Paralajmërimin (18.12.2013).

Ndërkohë, pas shkresës tonë të dytë, ztr. Kryeziu ka kontaktuar Agjencinë kundër Korrupsionit dhe ka njoftuar se ai tashmë nuk është në funksionin e Drejtorisë të Inspektoriatit komunal të Gjakovës, me çka ai nuk është me as zyrtar i lartë. Kjo është vërtetuar me rastin e deklarimit të pasurisë pas largimit nga funksioni (DP.03-214/14).

Po ashtu në këtë shkresë zyrtare jemi njoftuar se që nga data 30.12.2013 ztr.Kryeziu nuk e ushtron më detyrën e Drejtorisë te Inspektoriatit ne Komunën e Gjakovës dhe rrjedhimisht nuk është më as zyrtar i lartë i shtetit.

II. Në pajtim me nenin 18 paragafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtori i DPK-së
- Z./zpj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./zpj. (zyrtari ndihmës)

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

